



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine,
Prostornong Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
Kabineti i Ministrsit – Kabinet Ministra – Office of the Minister

| | |
|--|-------------------------|
| REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO | |
| MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE | |
| Njësia.org. Org.Jachica Org.Unit | Nr./Prot. Prot.No. |
| Nr./Faqeve Nr.Stranica Nr.Pages | Data/ Datum/ Date |
| 01 | 4379 |
| 01 | 28.5.24 |
| PRISHTINË / A | |
| No.2 | |

Zv. Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me nenin 12 paragrafin 5 nën paragrafin 5.3 të Ligjit Nr.08/L-117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 10 të Ligjit nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavaruara, (Gazeta Zyrtare, nr.7/01, dt. 01 Mars 2019), nenin 8 paragrafin 1, nën paragrafin 1.4, Shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) – Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 23 të Ligjit Nr. 2003/11 Për Rrugët si dhe nenin 11 dhe 12 të Ligjit Nr. 08/L-186 Për Rregullat e Trafikut Rrugor, merr këtë:

VENDIM

I. NDALOHET përkohësisht qarkullimi për të gjitha automjetet në trafikun rrugor në një pjesë të segmentit të rrugës Nacionale N2 Hani i Elezit – Kaçanik dhe anasjelltas nga data 01.06.2024 deri në njoftimin e radhës.

1.1. Devijimi Primar: Autoudha “Arben Xhaferi” për automjetet e rënda që kalojnë transit në Kaçanik.

1.2. Devijimi Dytësor: Rr. Agim Bajrami për automjete (përfshihen mjetet e rënda).

II. OBLIGOHET Operatori Ekonomik “G.C.F Generate Construzioni Ferroviarie dega në Kosovë”, që ti ndërmarr të gjitha veprimet për vendosjen e sinjalizimit të nevojshëm sipas planit të menaxhimit të trafikut për mbylljen dhe devijimin e qarkullimit të trafikut rrugor duke bashkëpunuar ngushtë me Departamentin e Menaxhimit të Rrugëve dhe Policinë e Kosovë për të krijuar kushte të sigurta për pjesëmarrësit në trafik.

III. OBLIGOHET Departamenti i Menaxhimit të Rrugëve dhe Departamenti i Inspektimit të bëjnë inspektime të rregullta për plotësimin eventual të shenjave të trafikut me qëllim të lehtësimit të qarkullimit të automjeteve.

Arsyetim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka pranuar kërkesën me numër protokollit 3814 të datës 07.05.2024 nga Operatori Ekonomik G.C.F Generate Construzioni Ferroviarie dega në Kosovë, punë kryes në projektin “Rehabilitimi i Pjesës Jugore së Hekurudhës 10 (Fushë Kosovë – Hani i Elezit) me të cilën ka kërkuar mbylljen dhe devijimin e një segmenti të rrugës Nacionale N2 me qëllim të zhvillimit të punimeve në hekurudha.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës pas shqyrtimit të kërkesës si dhe në pajtim me planin e menaxhimit të trafikut ka konstatuar se me qëllim të realizimit të punëve

publike në hekurudha është e nevojshme ndalimi dhe devijimi i qarkullimit të automjeteve në segmentet e cekura si në dispozitiv të këtij vendimi për të krijuar lëvizje të sigurt të automjeteve.

IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Hysen DURMISHI
zy. / Ministër i Ministrisë së Mjedisit,
Planifikimit Hapësror dhe Infrastrukturës



Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- OE G.C.F Generate Construzioni Ferroviarie dega në Kosovë;
- Departamentit të Menaxhimit të Rrugëve;
- Departamenti i Infrastrukturës Rrugore;
- Infracos;
- Komunës së Kaçanikut;
- Komunës së Hanit të Elezit;
- Policisë së Kosovës;
- Divizionit të Informimit;
- Arkivit të MI-së;